

kundërt të rrugës, ku ishte shtëpia e Rajkos. Pas pak, në vendngjarje u sollën edhe gratë serbe, të cilat kishin mbetur në shtëpitë e veta. Ushtarët i bastisën shtëpitë dhe, më pas, e lejuan varrosjen e Andelkos. Varrimi u krye rreth orës 15:00 nën mbikëqyrjen e ushtarëve të UÇK-së. Më pas, burrat u kthyen në qendër të fshatit, ku u rreshtuan sërish. Nga shtëpia e tyre u nxorën edhe Vitomiri dhe Živodarka. Grave u urdhëruan që t'i merrnin teshat dhe të largoheshin nga fshati. Burrat u dërguan me një kamion në drejtim të Opterushës/Opteruša, me arsyetimin se në shtabin e UÇK-së duheshin të nënshkruanin procesverbalin për dorëzimin e armëve. Ishte kjo hera e fundit që familjarët i shihnin të gjallë: Dimitrijën dhe të bijtë, Vekoslavin dhe Miroljubin; kushëririn e tij Mladenin me të bijtë Nebojshën dhe Vitomirin, vëllezërit Miodragun dhe Svetislavin; Srećko Kostićin, Saško Kostićin, vëllai i Jugosllavit të rrëmbyer [të shikohet regjistrimi], vëllezërit Todorin dhe Lazarin, Živko Kostićin, si dhe Rajko Nikolićin me djalin Cvetkon, shtatëmbëdhjetë vjeç.

Burrat mbahen në mend të shiheshin të gjallë herën e fundit në ditën e pacaktuar të muajit korrik të vitit 1998, kur pjesëtarë të UÇK-së i kishin nxjerrë ata, së bashku me burrat nga Opterusha/Opteruša, nga burgu i **Malishevës/Mališevo** [ndërtesa e stacionit policor], dhe i kanë dërguar në drejtim të panjohur. Fati i burrave të familjeve Kostić dhe Nikolić nuk ishte i njohur deri në muajin prill të vitit 2005, kur Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur u ka dorëzuar familjeve mbetjet mortore të të gjithë burrave, përpos Mladenit dhe Saškos. Mbetjet e tyre mortore ishin zbuluar në minierën e braktisur në fshatin Volljakë/Volujak në komunën e Klinës/Klina. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të anëtarëve të vet të vrarë më 14.10.2006, në varrezat Orlovaça në Beograd. Emrat e Mladenit dhe të Saškos ende gjenden në regjistrin e personave të zhdukur që administrohet nga KNKK-ja dhe rastet e tyre janë evidentuar në lëndët që i mbajnë numrat YUK-050091-01 dhe YUK-050095-02.

**Burimet:** deklarata K.K, FDH-400; deklarata M.N, FDH-460; deklarata M.D, FDH-470; deklarata L.K, FDH-583; deklarata C.B, FDH-3896; deklarata M.B, FDH-3897; deklarata V.V, FDH-3898; deklarata O.B, FDH-3900; deklarata V.K, FDH-13527; deklarata M.K, FDH-18936; deklarata R.Đ, FDH-18937; deklarata D.B, FDH-18939; deklarata Ž.K, FDH-29092; deklarata B.K, FDH-29094; FDH, *Regjistri i kufomave...*, FDH-12986; AIS, *Zona...*, 53, 56-57, 61, 63-64, FDH-16913; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, XVII, 310; *Šta je sa otetima*, Ilustrovana politika, 28.11.1998, 7-8, FDH-32281; FDH, *Fati i serbëve...*, 2-4, FDH-14277; HRW, *Po naređenju...*, 38, 78, 84, 359; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### Tafil (Nuhi) Zyberi

(10.05.1962, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Gani (Xhemë) Paçarizi

(15.05.1967, shqiptar nga Lubizhda/Ljubizda, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

### Agim (Veli) Kelmendi

(3.01.1973, shqiptar nga Bellacërka/Bela Crkva, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ganiu ka punuar në Gjermani para shpërthimit të luftës në Kosovë. Aderoi në UÇK në muajin mars të vitit 1998. E kryente detyrën e komandantit të policisë ushtarake në Drenoc/Drenovac. Agimi dhe Tafili u bënë anëtarë të UÇK-së në muajin prill të vitit 1998. Ganiu dhe Agimi kanë marrë pjesë në betejë për qytetin e Rahovecit/Orahovac.

Pas vendosjes së kontrollit mbi këtë qytet më 17.07.1998, Ganiu me një grup ushtarësh, në mesin e të cilëve ishte edhe Agimi, kaluan në Bellacërkë/Bela Crkva. Në këtë fshat, UÇK i ngriti barrikatat për të penguar kalimin e ushtrisë dhe policisë serbe nga Prizreni/Prizren dhe Gjakova/Đakovica drejt Rahovecit/Orahovac. Në datën 18.07.1998, Tafili shkoi, po ashtu, në Bellacërkë/Bela Crkva në ndihmë të njësiteve të UÇK-së. Që të tre kanë rënë gjatë betejës me forcat serbe, e cila u zhvillua më 18.07.1998. Ganiu gjeti vdekjen në rrugë në mes të fshatrave Bellacërkë/Bela